

shtron çështjen e periodizimit dhe të emërtimeve më të plotë të llojeve të krijimeve gojore, duke hedhur dritë mbi këto çështje. Në pjesën ku shqyrtohet „Ndarja dhe emërtimet e gjertanishme të llojeve të prozës popullore, A. Çetta jep historikun e klasifikimit të llojeve të prozës, që, siç theksohet këtu „u bë gjatë vitesh...“, ashtu siç mblidheshin shkallë shkallë shkallë edhe vetë materialet folklorike në prozë nga shkencëtarët dhe dashamirët e letërsisë sonë gojore”.

Ndërsa nën pikën 11 të po kësaj teme *Për plotësimin e ndarjes dhe të emërtimeve të llojeve të prozës popullore* ku është për t'u veçuar mendimi prijës i autorit „... duhet të mos ngurrojmë e të mos frikësohemi se mos po bëjmë ndonjë hap të gabueshëm nëse largohemi nga pak nga format e vjetra, të njohura mirë. Sepse, disa materiale të reja të mbledhura në kohë të fundit na imponojnë të krijojnë lloje të reja të prozës popullore e të gjëjmë emërtime të reja që përpara nuk i kishim”.

Prozën popullore autori e ndan në dy grumbuj të mëdhenjë *Tregimet popullore dhe llojet minore të prozës popullore*.

Meqë llojin e parë tregimet popullore i përcakton sikunder edhe deri më tash si proza” që kanë etapat e syzheut, në llojet minore të prozës popullore. A. Çetta, me formim të mirë filologjik, shqyrton dhe rishqyrton termat letrarë dhe çështjen e periodizimit të letërsisë gojore.

Në pjesën e dytë të librit të shqyrtim autori bën fjalë për fenomenet e poezisë gojore shqipe dhe për disa tipare të saj. Kështu në mënyrë të veçantë ai shqyrton çështjen e baladës dhe të transformimit të strukturës së saj, këngët e dasmës dhe nënllojet e tyre, pastaj flet për gjenezën dhe për këngën e Kurt Mehmetit dhe Sadik Ramës të familjes së Gjonbalaj nga Vuthaj etj. Edhe kjo pjesë dëshmon për njohjen e thellë të problemeve dhe për aftësitë e autorit që ato t'i hetojë dhe shkoqisë nga disa aspekte.

Në fund po themi se libri *Kërkime folklorike* i A. Çettës është me interes të shumëfishtë për folkloristikën tonë.

ISMAIL BELAJ

#### **ALBANSKE JUNAČKE PESME, zgjodhi dhe përktheu Dragutin Miqoviqi, „Jedinstvo”, Prishtinë, 1981.**

Ndërmarrja Gazetare-Botuese „Jedinstvo” e Prishtinës, në edicionin e Bibliotekës së Letërsisë Popullore, në verën që shkoi lëshoi në shitje veprën *Albanske junačke pesme* (Këngë shqiptare të trimërisë), zgjedhur dhe përkthyer nga Dragutin Miqoviqi. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me 18 këngë kreshnike shqiptare e jo me aso të trimërisë, siç është titulluar vepra, ndonëse në serbokroatishite ndoshta mund të shkojë edhe kështu në një kuptim më të gjerë, por pasi M. në 16 faqet e parathënies flet vetëm për këngët kreshnike shqiptare, mendojmë se edhe titulli i mirëfilltë *Albanske krajišničke pesme* e më mirë edhe *krešničke*, do ta arsyetonte më tepër përmbajtjen e veprës.

Kur Radosav Medenica në *Rad XIV kongresa folklorista Jugoslavije u Prizrenu*, Beograd, 1974, f. 233. na

informoi se Dragutin Miqoviqi i kishte përkthyer në prozë nja njëzet këngë kreshnike shqiptare në serbokroatishite, u gëzuam. Por, u gëzuam edhe më shumë, kur këto këngë na ranë në dorë të publikuara. Na u duk kënaqësi e posaçme, që diçka nga thesari i madh i krijimtarisë sonë popullore me larushi të madhe motivo-re, me vlera të larta letrare — artistike e gjuhësore — stilistike, i është ofruar lexuesit që e di serbokroatishiten.

Pasi i lexuam këto dhe i krahasuam me origjinalet, vërejtëm se përkthimi është bërë shkel e shko, pa përgjegjësi e me shumë të meta, të cilat gjymtojnë dukshëm një përceptim më të plotë e të saktë të vlerave reale të kësaj krijimtarie nga ana e lexuesit në gjuhën serbokroate anipse përkthyesi disa herë këto vlera i përmend në parathënie.

Përkthyesi i mbet borxh lexuesit kur nuk ia sqaroi, madje as rrugën që ndoqi në përkthim: i rikëndoi këngët, i përktheu fjalë-përfjalë apo u përpoq të imitojë rapsodin popullor serbokroat në gjuhë, në forma të shprehjeve, në stil e të tjera, që përkthimet t'i dalin më autentike e më të fuqishme. Ne, në këtë kontekst, konkluduar se nuk kishte ndjekur një parim të caktuar, por kishte vepruar sipas rasteve pa kritere të caktuara e rrugë unike, duke i dhënë vetes shpesh një liri të tepruar në përkthim dhe kështu e dëmtoi shumë origjinalin, të thuash sikur ua piu gjakun vargjeve, i zbrazi dhe i zvetënoi, i la shpesh pa domethënie e kuptim.

Pasi sot ekziston një numër i mirë vëllimesh të këngëve kreshnike shqiptare, disa prej të cilave Miqoviqi i përmend në punimet e tij, na duket se e ka çuar rruga të na informojë se prej cilit i zgjodhi këngët, në mos për tjetër, që ta plotësojë atë kërkesë shkencore kundrejt atyre që nuk kanë njohuri të nevojshme për këso veprash. Andaj, këtë mungesë të tij po e plotësojmë ne, duke shpaluar se pjesa dërmuese e rapsodive u zgjodh nga *Këngë popullore legjendare*, veper e Institutit të Shkencave, Tiranë, 1955, kurse ndonjë tjetër, që i mungoi së parës, nga *Visaret e kombit*, vëll. II, Tiranë, 1937.

Ne mendojmë se një pjesë të fajit për dështimet e këtij përkthimi e ka edhe edicioni i përmendur i „Jedinstvos”, i cili harroi se ndër ne tashmë është krijuar një plejadë folkloristësh shqiptarë, që di të dy gjuhët, e që po t'i besohej recensionit ose redaktura, do të duhej besuar se shumë të meta do të mënjanohehin me kohë, natyrisht në të mirën e përkthyesit, të Redaksisë dhe të kualitetit të dëshiruar.

Ndryshe, nga hulumtimet tona rezultoi se D. Miqoviqi e njihka shqipen pjesërisht, gjë që edhe u reflektua dëmshëm në kualitetin e përkthimit:

a) kur, për shembull, duke mos i kuptuar fjalët në tekstin shqip, u jep vargjeve kuptime krejt të tjera nga ç'i kanë në origjinal: *Shum denam Krajli kish ba, / Gjith miletin bashkue m'a ka e përktheu (Veliku kaznu Kralj je uveo / Sav narod je okupio)*, do të thotë fjalën *denam* në kuptimin e ahengut, të festës me

këngë e valle, e keqkuptoi dhe e përktheu në kuptimin *dënim*, anipse ndonjëherë i tha edhe *veselje*, por në rastet më të shpeshta, duke mos mundur t'i japë va, e kapërceu pa përkthyer.

„O nuk janë, jo krushq dasmorë, / Se ata paresh ranë në lumë” në përkthim ka dalë në një formë shumë të çoroditur („*To nam nisu svatovi za svadbu, / Jer bi pare u reku bacali.*”) Pra, fjalën *paresh* e ka kuptuar për *para* dhe ka gabuar. *Ka dhanë emën Krajli me bujri* në serbokroatisht ka dalë me një apsuritet që s'ta merr mendja (*Kralj je majci svojoj obećao*), varg që madje nuk e hasim fare në këngën shqipe e që edhe nuk ka kurrfarë logjike as në përkthim aty ku është vënë. *Sa në natjet Muja a çue*, duke mos kuptuar fjalën *natjet* e përktheu (*Noću se je Mujo podigao*) dhe i dha kuptimin e *natës*. *Me m'ngue mue rruqën ja lshojmë* varg fare i qartë në shqipe, për t'u habitur pse e përktheu (*Slušaj mene, da ga ne pustimo!*); *T'kam msue mazin si me e marrë* nuk mund të arsyetohet kurrësi përkthimi (*Dovešću ti ždrebe uhvaćeno!*); *Sot një javë flokët ja marr djalit, / Kumar Mujin qi p'e kam*; në shqipe kuptohet se Muja, si kumbar, do t'ia marrë flokët djalit të Arnautit, kurse në përkthim ka dalë (*Za nedelju strižem sina Muju, / Pošto sam mu kum šišanog kumstva*); pra krejt e kundërta, sepse Arnauti s'ia merr flokët të birit të Mujës, por ky i fundit djalit të Arnautit, moment ky që do të shfrytëzohet për të keq për t'ia vjedhur kalin Gjeto Basho Mujës nga ana e Krajle Kapidanit, por e kurdisur nga Arnauti, gjë që vërehet mirë edhe nga vargjet në shqipe edhe në serbokroatiste, për të dalë përkthimi i cituar më lart edhe më absurd dhe alogjik.

b) Këso menjanimesh nga origjinalet, ndërkaq ka edhe më shumë, jo aq për shkak keqkuptimesh, sa për shkak të kërkimit të rrugëve më të lehta në përkthim, si në këta shembuj: *I ka mbledhë treqind dasmorë, / Vesh me ar, shpatat flori (Skupio je tri stotine svata, / U zlato ih obukao, mačeve im ukrasio)*, që po kështu, nuk përkon me domethënien në shqipe, sepse *dasmorët* e kryekreshnikut s'kishin nevojë t'i vishte ai në

ar as t'ua flakëronte shpatat, pasi, tekefundit, as nuk kishte, por ashtu të veshur ata kishin ardhur në dasmë. *Kur t'delni n'maje t'bjeshkës, / aty janë tri mrize t'mdha* është porosia e Mujës dhënë dasmorëve që të ruhen nga zanat, kurse përkthyesi e fut edhe atë në atë veprim (*Kad stignemo na vrh od planine, / Naći ćemo tri velja plandišta*), që esencialisht e ndryshon kuptimin e porosisë dhe të veprimit.

*Me gji'nuse, ksajt kem'ra, / Ktyne mrizeve kem'pushue*, provokim i Dizdar Osman Agës kundrejt dasmorëve të Mujës, por i transponuar keq në serbokroatishte (*Do neveste uvek sam stigao, / Odmarao na ovim vrsima*), sepse nuk përkon fare me domethënien në shqipe. *A se ndeshem m'trevezë t'tyne, / A se gjumin Agët ja xueren* ia shpjegon Mujës nusja rastin e ngurrimit të kreshnikëve nga zanat, kurse përkthyesi e gjen të kundërtën (*Ili smo mi nagazili na njihovo plandište, / Ili je age sanak uhvatio*), në vend se të përkthehej se agët mund t'ua kenë nxjerrë gjumin zanave, në serbokroatishte doli sikur agët kanë rënë në gjumë. *Se me dalë kush qi me i xanë gjallë, / „T'tanë forceja u maron!”*, kurse M. i jep kuptim të kundërt (*Jer ako se takav igde nađe, / „Ne može im snagu ugrabiti!”*), pra dhive të egra briarta, në të cilat zanat kishin forcën. *Kur ka dredhun syt prej Majes s'Xhurit*, toponimi *Maja e Xhurit* është keqkuptuar dhe keqpërkthyer (*Dok ugleda tamo iznad Žura*); *Por n'qafë m'paqi, mori Bjeshkët e Nalta, / Kurruku i shtek qi nuk ma latë* (*Idem sada u Velje Planine, / Gde još nema staza ni bogaza*), përkthim ky ndër më të lehtë e më të thjeshtë, por edhe më të paqëlluarit. *E n'Krajli gjâ me ta gjetë, / Sa t'jeshë gjallë djallit ja kujton!* (*Kraljevinom svašta može biti, / Pamtiće ti momče dogod diše!*) një moskuptim i plotë i vargjeve shqipe. *Ka xjerrë Muji vllanë e vet, / Muer Halili 'i vashë mbetë shkret!*, do të thotë se rapsodi i pezmatuar nga gjithë ajo kërdi që u bë për një vajzë, mallkoi, kurse M. e përktheu mrapshtë (*Da je Mujo brata odrobio, / Baša Halila — kome ostade devojkja*), vërtet sa përkthim i përçudshëm!

*Dern e burgut nuk po e mbyllë* (*Od podruma vrata mu zatvara*) e kundërta. *Ma t'mirë mazin s'ke pse e lypë.* (*Dalje ždrebe nemoj da mi tražiš.*), po ashtu. *Si s'ma msuet mue ni kopili, / Si të dalim prej ktij burgu të zi.* (*Sto kopile neko mi ne kaže, / Iz tamnice kako da izidem!*), pra as njera as tjetra si në shqipe. *„Nusen ty për t'gjallë nuk ta marr!”* i thotë Sokol Halili Zukut Bajraktar, kurse M. i dha tjetër kahje (*„Ti nevestu živ uzeti nećeš!”*; *„Ja i dekun, me sy s'ke si me m'pa.”* (*„Mrtav ležim, očima ne vidim.”*) prapë gabim. *Me lot faqet trimit m' iu kanë mbushë, / „Erzi i shpisë qysh lshohet n'dorë t'balozit?!”* (*Po licu, mu sestrine suze pokapale, / „Kako će obraz kućni okalati.”*) e këso deformime mendimesh sa të duash fund e krye kësaj vepre.

c) Se deri në ç'masë janë shëmtuar këto tekste në përkthim, dëshmon më së miri rasti i Hysen Kraposhnikit në rapsodinë po me këtë titull, i cili dergjej shtatë vjet nga nëntë plagë pushkësh dhe, me shpresë të humbur për jetë, ia fali të fejuarën vëllamthit Ymer Delisë, por në rrugë për martesë, nusja ndalet të bujë një natë te i sëmuri, të cilit, gjatë natës, do t'ia mbysë tre gjarpërinjtë: të ziun, të kuqin dhe të bardhin, që për çdo mesnatë ia lëpinin plagët dhe nuk e lejonin të shërohej. Të nesërmen, i shëruar, Hyseni ndal nusen, e në vend të saj vëllamthit ia dërgon motrën me dasmorët, që mos t'i lëshojë ata duarthatë. Mirëpo, Ymer Delia, duke e konsideruar atë si motër të vetën, me treqind dasmorët shkojnë t'ia përhaprojnë Hysenit shërimin dhe martesën, dukë ia kthyer edhe motrën: *„Ku je ti, thotë, Hysen Kraposhniki? / Treqin krushq me vetit t'i kam marrë, / Motrën tane me vetit ta kam pru, / Un kam ardhë dazmën me ta ba!”* kurse përkthyesi gjithë kësaj burrërie ia ndërroi fare kuptimin (*„Gde si, more, Husen Krapošniku, / Trista svata sa sobom dovodim, / Tvoju sestru uzimam za ženu, / A tebi sam doćao na svadbu!”*) që nuk përkon me përmbajtjen e vargjeve.

c) Ndonjëherë përkthyesi le përshtypjen se është pak si i habitur, i tretur në mendime, sepse si do të mund të shpjegohej ndryshe e dhë-

na, që ngatërron njëjësin me shumësin ose të kundërtën, që bën edhe ndërrimin e numrave, si bie fjala: *Kanë ba dazëm e kanë ba gajret, / Pa pushue shtat dit e shtat net!* (Napraviše svadbu i veselje, / Bez prestanka šest dana i noći); ose: *Un gjasht dit n'zjarm i kam mbajtë (Sedam dana sam ga ognju držao)*, pra pa kurrfarë nevoje gjashtëshin e bën shtatësh e shtatëshin gjashtësh! Në këtë kontekst në përkthim vërejmë edhe deformime të këtilla: *Bash si dielli ftyra po i shkëlqen (Kao sunce što mu sunce sija)*, që nuk mund të pranohet si ndonjë gabim shtypi, por thjesht si habi apo nguti e përkthyesit, sepse ndryshe do të duhej përkthyer (*Kao sunce lice mu tako sija*) e sigurisht do të mund të përkthehej edhe më mirë.

d) Përkthyesi, pos të tjerash, i kishte dhënë vetes liri aq të madhe, sa që edhe emrat e përveçëm i ka përkthyer, si për shembull: *Del e bija e Molles Ahmet Agë / Për martesë çika ish kanë ba (Iskočila kći Jabuke Ahmet-age, / Stasala je cura za udaju)* gjë që nuk na ka rënë të shohim në përkthimet e mirëfillta.

dh) Po kështu, na habit e dhëna, pse M. la pa përkthyer një numër të konsiderueshëm vargësh nga rapsoditë shqiptare, si bie fjala: *Aj kah mot â dyndë Krajljet; Edhe ndejë â çue prej tremet; Hiç s'po i nepet djalit me qindrue; Ka marrë kangën e po kndon; Fort serbes Zoti e ka falë; Atherë foli Sokol Halili; Tanë kall dramën po e thermon* etj., sikurse edhe shtoi bukur shumë vargje, që nuk hasen në rapsodi: *Kralj je majci svojoj obećao; Tad devojka Halilu govori; Da mu u njoj momak ne ostane; A drugo ti ja ništa ne tražim; Traga od vas nigde biti neće e të tjerë e të tejra, që sipas mendimit tonë, nuk i kontribuojnë fare çështjes së përkthimit e as kualitetit të tij.*

e) Përkthimi i pjesërishtëm i vargjeve, duke lënë pjesë të tëra pa i thënë, ndonjëherë edhe duke i përgjysmuar, i ka dëmtuar shumë mendimet e rapsodit shqiptar, sepse ashtu nuk ka qenë e mundshme të jepet tërësia e vargjeve në shqipe, si në këta shembuj: *Sa po lahen agët ndër gurra e kroje*, u thjeshtua maksimalisht (*Kako mi se age umivaju*), pra duke mënjanuar gurrat e kro-

jet, që gjithsesi kanë domethënien e bukurisë së shprehjes. *Kanë ba ashtat trimat me ushtue (Uzbučaše reke i planine)*, por prej kujt e përse nuk del në serbokroatishte. *Kanë ba gjo-gat trimat me flutruë (Poletošë džoge od megdana)*, apo *Kanë gjimue malet si për mot t'lig (Zaječaše planine olujom)*; *Me shtjelma e topuz vorrin po ma rreh (Pa po grobu topuzinom lupa)*; *Pse me m'qitë, bre burrrë, n'kët fushë mejdanit? (I šta tražiš ovde na megdanu?)*; *Pikt ndër shtroje kaq shpejt qysh m'i lshuet (Kad ste i vi pokisnuli pusti)* e shumë shembuj të këtillë, vërtet për t'u habitur.

ë) Përdorimi i rrokjeve në përkthimin e rapsodive shqiptare në skr. është një çështje me interes të posaçëm kësaj radhe. Vërtet, se çfarë mase do të përdorë përkthyesi, ajo është rrugë që mund ta zgjedhë vetë, por atëherë do të duhej ndjekur një parim të caktuar. Miqoviqi, sado që pati të bëjë kryesisht me dhjetërrrokëshin e këngëve kreshnike shqiptare, të cilin në disa shkrime ai më parë e nxori si analog me „desetercin” serbokroat, pati rast të bindet në praktikë, se nuk kishte pasur të drejtë, sepse po të ishte i atillë vargu shqiptar, edhe do të përkthehej fare lehtë po me atë masë. Pëkundrazi, dhjetërrrokëshi i këtyre rapsodive ka specifikat e veta dhe, pos nëse veprohohet duke lënë pa përkthyer pjesë të tëra, siç veproi M. është të thuash e pamundshme të përkthehet me „deseterc-in”.

Në këtë synim ai tetërrrokëshat e vargjeve shqipe disa ia doli t'i kthelë në dhjetërrrokësh në skr. si në këta shembuj: *Njaty rueni se lodroni! / Njaty kangën mos e kndon!* (Çuvajte se, tamo ne igrajte, / Tamo nemoj, pesme da pevate) e në shumë të tjerë. Ndryshe, vërejmë në këtë vëllim të përkthyer kaq anomali, kur fjala vjen, u përkthyen vargjet shqipe në skr. prej shtatë e deri në shtatëmbëdhjetë e më rrokje, si bie fjala: *Mujin nusja p'e pëvetë (Pita nevesta Muja)* — (7 rrokësh); *Tridhetë krushq t'ngritë i ka gjetë (Trideset skamenjenih svatova je zatekao)*, (15); *Pasha t'Lumin qi sundo tokë e qiell (Tako mi svevišnjeg što zemljom i nebom vlada)*, (14); *Çika e Krajlit tu kryet i ka qillue (Kraljeva se kći kraj*

glave mrtvaca zadesila), (14); *Nanë vjet, djalë, ethet të kin zanë (Ne bi te za devet godina pustila groznica, momče)*, (17) e shumë të tjera.

f) M. fjalën *kushtrim* e sqaroi në skr. me: „Ko je junak”, „kojunak” e „kovitez”, por në tekstet e mëtejme nuk e përktheu fare dhe bëri mirë, sepse kështu i doli më e fuqishme, më e lëngshme. Kështu, mendojmë se do të duhej të vepronte edhe me emrin (*shka* (shkja) e *shkie* (shkje), të cilit është vështirë t'i gjendet ndonjë fjalë gjege në gjuhën e përkthimit. Andaj, nuk na duket qëlluar që në të gjitha rastet e përktheu me *slaven* dhe *slaveni*, sepse pavarësisht pse një shpjegim të tillë mund t'i ketë dhënë ndonjë linguist këtij emri, e vërteta është se rapsodi shqiptar nuk e përdor me atë kuptim. Këto fjalë këtu kanë kuptim etnografik; ato tregojnë banorin e Krajlisë, njerëzit e krajlave që luftojnë kundër tyre, gjithë ata që jetojnë rreth e qark atdheut të kreshnikëve. Përndryshe, në këtë kontekst ne mund t'i sjellim Miqoviqit me dhjeta e dhjeta shembuj, kur kreshnikët

shqiptarë shkojnë në Talir (Ita More (Greqi), Maxharr, Miskov, Qesar (Austri), Nemc (Gjermani) e ndonjëherë edhe në Bagdat, që ishte radiusi më i gjerë i bredhjeve të tyre në aventurat martesore e të tjera dhe, prore rapsodët do të thonë, në mënyrë të përgjithësuar, se kanë shkuar ndër shkje. Për më tepër nocioni *slaveni* nuk përkon, kur dihet se këta heronj nuk luftuan kundër kurrfarë kombi e feje, por në shënjestër patën prore krajlrat e ndryshëm, kapidanët dhe sejmënët e tyre.

Këto qenë vetëm disa nga vërejtjet tona përkthimi me përkthimet e dobëta të këngëve kreshnike shqiptare, duke mos pretenduar se i kemi thënë të gjithat, sepse ka aq shumë e për të cilat do të mund të shkruhej një vepër e tërë. Megjithatë, do pranuar se një përkthim të mirë të kësaj lënde kaq të pasur me fjalë e shprehje, me figuracion poetik kaq të dendur e të qëlluar, do të mund ta bënte vetëm një njohës i mirë i të dy gjuhëve, i cili do të kishte edhe një dell të mirë e vesh të hollë poeti.

DEMUSH SHALA

**Dushko Naneski: KALI I ZANËS (Përralla popullore maqedone) botoi „Rilindja”, Prishtinë, 1981.**

Dushko Naneski është një nga kritikët e njohur maqedonas. Është i orientuar më shumë kah poezia, me interesim të posaçëm për artin poetik popullor: shpjegon mitet e simbollet, ndjek gjuhën e tyre deri te shprehja moderne. Ka botuar deri tash këta libra: „*Këngë popullore të dashurisë*”, 1971, „*Shkolla poetike maqedone*”, studime dhe ese, 1977, „*Bilbili i zi*” antologji e poezisë maqedone, ndërsa veprën „*Kali i Zanës*” (Përralla popullore maqedone) me stil të autorizuar e botoi më 1978.

Libri i tij „*Kali i zanës*” (Përralla popullore maqedone) doli si botim i „Rilindjes” edhe në gjuhën shqipe në vitin 1981.

Libri përmban një parathënie të shkurtër nga vetë autori, ku, ndër të tjera, thekson metodën e punës dhe qëllimin e ndërmarrjes së tij për t'u dhënë lexuesve një libër me përralla të zgjedhura sipas shijes së tij e sidomos edhe të përshtatura në gjuhën

letrare në stilin e tij poetik, ashtu siç patën vepruar para tij për lexuesit e tyre Vëllezërit Grim dikur, Charl Pero ose Rozhan Nemocova, duke bërë transliterimin e gjuhës së folklorit në atë letrare. Libri përmban edhe një parathënie dhe një pas-thënie nga përkthyesi.

Duke lexuar përrallat e këtij libri, vërtet bindemi për bukurinë që përmbajnë përrallat si art gojor i popullit. Këtu janë përfshirë njëzet sosh. Këto përralla të përkthyer shqip vijnë e hyjnë në botën tonë shpirtërore duke na kënaqur me përmbajtjen që sublimojnë, me mjetet e bukura artistike, e sidomos me simbolikën e qëlluar. Ja pra një vepër që do të lexohet me ëndje si nga të vegjlit ashtu edhe nga të rriturit: prindërit, mësuesit dhe studiistët e folklorit.

Dihej fare mirë se përrallat janë të ngjashme ndër të gjithë popujt e botës. Dhe kryesore e me rëndësi është një çështje: ato janë gjithkund,